



Prania / Dorezuar Primen / Predato Recieved / Delivered	22-08-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot No Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSACK	4872/2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.562/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti- dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.562/2022 të datës 24.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

në Komunë të Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kundër caktimit të zëvendësuesit" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatëshme ankesa me numër A.nr.562/2022 e datës 24.06.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI), sipas Akte emërimit të datës 8.04.2016 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Pyetës", në Departamentin për Patentë Shofer, me datë 24.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 3680/2022, kundër Vendimit me numër Nr.01.7903 të datës 14.09.2021 të ish Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për caktimin e nëpunësit civil F.M nga pozita "Udhëheqës i Divizionit për Transport dhe Mallrave", në kuadër të Departamentit të Transportit Tokësor në pozitën e Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë

29.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë. Ndërsa me datë 05.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitur të lëndës prej 1/6 faqe.

Me datë 05.08.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me VK.nr.71/2022 për vazhdimin e afatit të ankesës me numër Anr.562/2022 të datë 24.06.2022 .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 24.06.2022, me numër të protokollit 3680/2022 të regjistruar me numër A.nr.562/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akte emërimit të datës 8.04.2016; Vendimi Nr.01.7903 i datës 14.09.2021 të ish Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë; Opinion Ligjor nr.protokolli 3316 i datës 05.11.2019; Përgjigje në ankesë e datës 05.07.2022; Përshkrimi i detyrave të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 14.09.2021 ka nxjerrë Vendimin numër protokollit 7903, për caktimin e nëpunësit civil F.M nga pozita "Udhëheqës i Divizionit për Transport dhe Mallra", në kuadër të Departamentit të Transportit Tokësor në pozitën e „Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer”.

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), sipas Akte emërimit të datës 8.04.2016 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Pyetës", në Departamentin për Patentë Shofer, me datë 24.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 3680/2022, kundër Vendimit me numër protokollit 7903 të datës 14.09.2021 të ish Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me pretendime ankimore se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin në fuqi, gjegjësisht me caktimin e Udhëheqësit të Divizioni nga Departamenti tjetër janë shkelur dispozitat materiale dhe dispozitat procedurale si dhe i është cenuar e drejta për avansim dhe është diskriminuar pasi që ai është Udhëheqës i Divizionit për Pyetës në kuadër të Departamentit për Patentë Shofer.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 përcakton se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 3. „Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacione, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni është tre (3) muaj”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, konstaton se, që nga koha kur është nxjerrë Vendimi me numër protokolli 7903, i datës 14.09.2021 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për caktimin e nëpunësit civil F.M nga pozita "Udhëheqës i Divizionit për Transport dhe Mallra", në kuadër të Departamentit të Transportit Tokësor në pozitën e „Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer“, deri tek data 24.06.2022 kur ankuesi ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me numër protokolli 3680/2022, kanë kaluar të gjitha afatet ligjore të përcaktuara në nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se” **1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ**”, ndërsa sipas nenit 51 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **1. Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij**”, si rrjedhojë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 24.06.2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **„Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ” si dhe 3,, Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacione, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike), afati i parashkrimit nga paragrafi 1 i këtij neni është tre (3) muaj**”. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se Vendimi me numër protokolli 7903, i datës 14.09.2021 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për caktimin e nëpunësit civil F.M nga pozita "Udhëheqës i Divizionit për Transport dhe Mallra", në kuadër të Departamentit të Transportit Tokësor në pozitën e „Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer“ ka hyre në fuqi në ditën e nënshkrimit si dhe po ashtu nëpunësi civil F.M e ka ushtruar detyrën e Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer nga data 14.09.2021, ndërsa ankuesi Besim Tahiri nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht nga data 14.09.2021 kur ankuesi është njoftuar me Vendimin me numër protokolli 7903, të datës 14.09.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i cili vendim ka qenë pa këshill juridike dhe me Zëvendësuesin e Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer” sepse nëpunësi civil F.M e ka ushtruar këtë detyrë nga data e lartpërmendur, andaj Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor gjegjësisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka parashtruar ankesë në kuadër të institucionit të punësimit apo në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative .

Duke u bazuar në faktet e lartcekura dhe në bazë të dispozitave ligjore të specifikuara si më lartë, ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të

Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se:” 1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji”, në këtë rast ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit ligjor sipas dispozitave të lartë cekura.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.562/2022

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Malsore Gashi Bajraktari
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë ,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

